

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e RKS-së" nr.28/2008), nenit 53 paragrafi 3 të Ligjit nr.05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr.20/2016), nenit 13 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Graçanicës nr.6320/15 të datës 22.10.2015 dhe Kërkesës së MAPL-së nr.020-399/8 të datës 07.07.2025 për rishikimin e aktit, Kuvendi Komunal i Graçanicës në mbledhjen e parë të jashtëzakonshme, e mbajtur më datën 31.07.2025, merr këtë:

VENDIM NR.45/2025/KG

për anulimin e Vendimit Nr.2405/21 të datës 26.05.2021 (Nr.29/2021/KG) për shpalljen e parcelës nr.909/26 ZK Çagllavicë me interes të përgjithshëm publik

Neni 1

ANULOHET Vendimi nr.2405/21 i datës 26.05.2021 (Nr.29/2021/KG) për shpalljen e parcelës nr.909/26 ZK Çagllavicë me interes të përgjithshëm publik.

Neni 2

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, anulohet edhe Vendimi nr.2611/25 (Nr.40/2025/KG) i datës 24.06.2025 për anulimin e Vendimit nr.2405/21 të datës 26.05.2021 (Nr.29/2021/KG) për shpalljen e parcelës nr.909/26 ZK Çagllavicë me interes të përgjithshëm publik.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit të vendimit në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Graçanicës.

Arsyetim

Me Vendimin nr.2405/21 të datës 26.05.2021 (Nr.29/2021/KG) KK i Graçanicës e ka shpallur parcelën nr.909/26 ZK Çagllavicë me interes të përgjithshëm publik me qëllim të përmbushjes së qëllimit publik.


Me Vendimin nr.2887/21 të datës 15.06.2021 është aprovuar këmbimi i pronës së paluajtshme të komunës me parcelën nr.909/26 ZK Çagllavicë, ku pas kësaj Komuna e Graçanicës pranoi një letër njoftimi të datës 16.06.2021 nga MAPL-ja, që në përputhje me nenin 10 të Ligjit nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës dhe nenin 33 të Rregullores QRK për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e

pronës së paluajtshme të komunës, Kuvendi i komunës dhe ekzekutivi i komunës nuk mund të merr asnjë vendim për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës pas Vendimit nr.44/2021 të datës 15.06.2021 për shpalljen e zgjedhjeve lokale.

Më datën 28.09.2022, KK i Graçanicës ka marrë një Vendim të ri nr.5026/22 të datës 28.09.2022 (Nr.54-2022-KG) për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, i cili i referohet të njëjtës pronë të paluajtshme. Duke i respektuar interesat e qytetarëve nga territori i Komunës së Graçanicës, KK i Graçanicës, me propozim të kryetares së komunës, mori Vendim nr.5609/22 të datës 21.10.2022 (Nr.58-2022-KG) për anulimin e Vendimit nr.5026-22 të datës 28.09.2022 (Nr.54-2022-KG) për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, ku pas kësaj komuna pranoi konfirmimin e ligjshmërisë nr.020-862 të datës 22.11.2022 nga MAPL-ja.

Duke u bazuar në të gjitha sa më sipër, Komuna e Graçanicës nuk ka më interes publik në aspektin e parcelës nr.909/26 ZK Çagllavicë, prandaj mori Vendim nr.2611/25 të datës 24.06.2025 (Nr.40/2025/KG) për anulimin e Vendimit nr.2405/21 të datës 26.05.2021 (Nr.29/2021/KG). Pas përfundimi të vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, komunës i është dërguar kërkesa nr.020-399-8 të datës 07.07.2025 për rishikimin e aktit për shkak të mospërmbushjes së dispozitave të nenit 43 paragrafët 3 dhe 4 të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, si dhe nenit 47 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.3 dhe nenit 52 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.4 të Ligjit nr.05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative.

Prandaj, Kuvendi i komunës e harmonizon aktin me legjislacionin e lartpërmendur dhe merr vendim si në nenin 1 të dispozitivit të këtij Vendimi.



Kryesuesi i Kuvendit

Milan Dapitrijević

Milan Dapitrijević